

Nr. .... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2023

## FTESË PËR OFERTË

*“Për sistemin dinamik të biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar”*

### Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)  
Adresa Blloku “Vasil SHANTO” ,P.O. Box 259/1 Tiranë.  
Tel/Fax +04 22 30 888,  
E-mail dedae@kesh.al  
Adresa e Internetit [www.kesh.al](http://www.kesh.al)

Autoriteti kontraktor KESH sh.a., do të zhvillojë procedurën e prokurimit nëpërmjet sistemit dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar, me objekt: **“Blerje 6 (gjashtë) bileta avioni”** me destinacion Bukuresht (Rumani), në datat 10 Shtator – 15 Shtator 2023.

**Data e zhvillimit do të jetë 08.09.2023 (jo më pak se 3 orë nga momenti i publikimit), ora 14:00 në adresën: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

### Specifikimet teknike:

#### **Bileta Avioni, sasia 6 (gjashtë).**

- Nisja do të bëhet nga Tirana për në Bukuresht (Rumani) në 10 Shtator 2023 (në drekë, pas orës 14.00 pm), dhe mbërritja në destinacion brenda orës 24.00.
- Kthimi nga Bukuresht (Rumani) për në Tiranë do të bëhet në datë 15 Shtator 2023 (pasdite, pas orës 18.00 pm).
- Fluturimi të jetë linjë direkte/jo më shumë se një tranzit.
- Klasi ekonomik (economy flex).
- Bagazhi i përfshirë, per secilin.

**Operatori ekonomik i renditur i pari, perpara se te shpallet fitues, duhet te dorëzojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, dokumentet si me poshtë:**

1. Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar;
2. Operatori Ekonomik duhet të ketë te parashikuar në objektin e veprimtarisë së tij fushën e objektit të prokurimit.
3. Një dokument që vërteton se subjekti juaj ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore.
4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të faturave.
5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara deri në muajin e fundit të energjisë elektrike .

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Çdo kriter i mësipërm, i cili nuk plotësohet, përbën kusht për skualifikim.**

*Në rast anulimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, Operatori Ekonomik do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e itinerarit.*

- OE duhet të garantojë përballimin e çdo pasojë të mundshme ekonomike, në raste të jashtëzakonshme, si fatkeqësi natyrore, kushte të këqija të motit, grevë apo falimentim të operatorit, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit, të cilat nuk vijnë si pasojë e veprimit të Autoritetit Kontraktor.

Afati i dorëzimit të dokumenteve do të jetë jo me pak se 2 (dy) orë nga shpallja e njoftimit të fituesit. Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues në zyrën e protokollit të KESH sh.a. Në të kundërt, do të bëhet kalimi të ofertuesi i radhës i kualifikuar në SPE, e kështu me radhë, deri në ofertuesin e fundit të mbetur në klasifikim.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

**PËR TITULLARIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR  
PERSONI I AUTORIZUAR**

**Aurel GRECA**

Konceptoi: E.Deda  
Data: Shtator 2023  
Nr. kopjeve: 2 (dy)